



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 1883/Prot
Dt. 15.04.24



Shkodër, më 11.04.2024

Nr.257/1prot.

Lënda: Mbi vendimin Nr.24 datë 27.03.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes.

KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore" ndryshuar, neni 15, neni 18/3, neni 54/n, neni 55/2, Urdhërit të Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB Nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", neni 4, neni 5, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejes Nr.1879.Prot datë.3.04.2024 "Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentacionin shoqërues të mbledhjes të Këshillit Bashkiak Vau-Dejes, të datës 27.03.2024", shqyrtoi VKB **Vau-Dejes Nr.24, date 27.03.2024** "Mbi miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Vau-Dejes".

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 24 datë 27.03 2024

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCES NË BASHKINË VAU DEJËS”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës i mbledhur me datë 27/03 2024, në mbështetje të nenit 9, 15, 18/3, 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 4 dhe 5 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në Urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjes së të Dhënave Përsonele, Nr.211, datë 10.09.2018, “Për Miratimi e Programit Model të Transparences në Njesitë e Qeverisjes Vendore”, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, pasi shqyrtoj projekt-vendimin e paraqitur për miratim nga “Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK”, me shumicë të votave:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

- 1.Miratimin e “Programit të Transparences” në Bashkinë Vau Dejës, të njësive dhe strukturave administrative në varësi të saj, sipas tabelave përmbledhese bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ky program të publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”, si dhe në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.
- 3.Për zbatimin e “Programit të Transparences”, ngarkohet Kryetari Bashkisë Vau Dejës, Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK, Kordinatori i Transparences, si dhe të gjitha strukturat administrative dhe organizative në varësi të Bashkisë Vau Dejës.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të bera në piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.i ndryshuar.

K R Y E T A R K Ë S H I L L I T

Ervis Shimaj

SEKRETAR KËSHILLIT

Adrian Pelopaj

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. _____ prot

Dt. _____ / _____ 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Datë 20 / 03 2024

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCES NË BASHKINË
VAU DEJËS**

Bazuar në nenin 9, 15, 18/3, 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 4 dhe 5 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, në Urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjes se të Dhënave Përsonele, Nr.211, datë 10.09.2018, “Për Miratimin e Programi Model të Transparences për Njësitë e Qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, pasi shqyrtoj projekt-vendimin e paraqitur për miratim nga “Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK”, me shumice absolute votash,

VENDOSI:

- 1 Miratimin e “Programit të Transparences” për Bashkinë Vau Dejes dhe të njësive administrative dhe organizative në varësi, sipas tabelave përmbledhese bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2 Brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ky program të publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”, si dhe në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.
- 3 Për zbatimin e “Programit të Transparences”, ngarkohet Kryetari Bashkisë Vau Dejës, Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikes dhe TIK, Kordinatori i Transparences, si dhe të gjitha strukturat administrative dhe organizative në varësi të Bashkisë Vau Dejës.
- 4 Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të bera në piken 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.i ndryshuar.

HARTUAN PROJEKTIN

Kordinatori i Transparences
Mersilda Meti

Përgjegjes Sektori
Arion Prenga

Drejtori
Bib Miria

Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjes i Sektorit Ligjor

Jaishin Shtet

KRYETARI I BASHKISË
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URHDHËR
ZV/KRYETARI
Gjovani Zefi



RELACION

MBI **HARTIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCES NË BASHKINË VAU DEJËS**

Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme në Njësinë e Qeverisjes Vendore. Transparenca është publikimi i informacionit mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkise Vau Dejes, të organeve dhe administrates se saj, menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofron bashkia, pjesëmarrja e qytetareve në vendimmarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në mënyrë të tillë që të jenë të aksesueshëm dhe lehtësisht të kuptueshme nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoritet vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve dhe ndërtimit të besimit me komunitetin.

Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare.

Nëpërmjet këtij programi, Bashkia Vau Dejes vendos në dispozicion të qytetarëve një kategoritë gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato. Ky projekt është hartuar në përputhje me nenet 9,15,18/3, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjern vendore”, i ndryshuar, më nenin 4,5,7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, si dhe në urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Përsonele Nr.211, datë 10.09.2018, “Për Miratimin e Programit Model të Transparences në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Për garantimin e të drejtës së informimit, bashkia në hartimin e këtij programi është bazuar në parimin e:

- a) **Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari**, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria administrative e bashkisë dhe organeve administrative në varesi të saj.
- b) **Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit.**
- c) **Ofrimit të informacionit pa pagesë.** Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në 10 faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari paguan një tarifë shërbimi sipas parashikimeve të bera në paketen fiskale të cdo viti buxhetor.
- d) **Aksesit për këdo.** Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësitë kufizuar, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj., merr përparësi.
- e) **Thjeshtëzimit të procedurave administrative për aksesin në informacion.**
- f) **Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur**

g) **Cilësisë së informacionit.** Çdo informacion në dispozicion të qytetarëve do të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në administrim të bashkisë;
- lehtësisht i përdorshëm.

INORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA PAGESË

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm të 16 kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, janë përshtatur me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Në këtë optikë tabela përmbledhëse e këtij programi është ndarë në 7 fusha kryesore:

Fusha e parë: *Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë*, përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nëndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikat vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë: *Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare*, përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; e; ë) i ligjit. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qiratë pronave dhe aseteve.

Fusha e tretë: *Për kërkesat për informim*, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuara në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit, në një fushë të vetme, lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

Fusha e katërt: *Mbi shërbimet që ofron bashkia Vau Dejes*, përfshin informacion mbi shërbimet të përcaktuara në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit.

Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbime

publike që ofron Bashkia Vau Dejes, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Fusha e pestë: *Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore*, informacion i përcaktuar në nenin 7, pika b të ligjit. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikat, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të organevetë Bashkisë Vau Dejes. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve.

Fusha e gjashtë: *Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje*, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore qëi nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

Fusha e shtatë: *Informacion tjetër*, Bashkia Vau Dejës vë në dispozicion të qytetarëve informaciontë ndryshëm të tillë si proceset e integritimit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar etj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Tuaj i kërkojme Këshillit të Bashkisë Vau Dejës të miratojë projekt-programin e paraqitur nga ana jone i pasqyruar në tabelat bashkëlidhur.

RELATORI

DREJTORIA E INFORMIMIT PUBLIK, MEDIAS, STATISTIKES DHE TIK

Specialisti i Informimit Publik

Mersilda Meti



Përgjegjesi i Sektorit

Arion Prenga



Drejtori

Bib Miria

